

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – departamenti i krimeve të rënda, kryetar i trupit gjykues Artan Sejrani, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Florije Kolukaj procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarve H.A. nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 parag. 1 të KP-së dhe B.S. nga ... për shkak të veprës penale dhënia e ryshfetit nga neni 429 parag. 1 të KP-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren - departamenti i krimeve të rënda PP/I.nr.158/2017 të datës 23.10.2017 pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë në praninë e Prokurorit të shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre av. A.K. dhe H.K. që të dy nga ..., me datë 30.11.2017 publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.H.A., nga i ati I..., dhe e ëma G..., e lindur ..., i lindur më datën ..., në fshatin ..., Komuna e ..., ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me profesion instruktor, i martuar baba i dy femive, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër ... të lëshuar nga MPB-ja në Prishtinë.

2.B.S., nga i ati R..., dhe ëma Gj..., e lindur ..., i lindur me dt. ... në ..., ku edhe tani jeton në rr. "..." pn, i pa punë, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër ... të lëshuar nga MPB-ja në Prshitinë.

JANË FAJTORË

I akuzuari H.A.:

I. Se me datën 29.09.2017, rreth orës 08:25 minuta, në Prizren në cilësinë e personit zyrtar instruktor dhe pronarë i auto shkollës "...", me seli në ... në mënyrë të drejtë për drejtë pranon përfitim për vete që të mos veprojnë në pajtim me detyrën e tij zyrtare ashtu që nga kandidati B.S. pranon 300 (treqind) euro, për të mundësuar dhënien e testit teorik për patentë shofer, ashtu që vendos në trupin e B... pajisje elektronike për të komunikuar dhe ndihmuar në plotësimin e testit, me ç'rast gjatë testit teorik për patentë shofer në trupin e B.S. zbulohen pajisje dhe përçues elektronike nga ekzaminieri J.M. dhe koordinatori i departamentit të patentë shoferëve.

Këso dore ka kryer veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 parag. 1 të KP-së.

I akuzuari B.S.:

II. Se gjatë gushtit të vitit 2017 në kohë të pacaktuar në fshatin ... në mënyrë të drejtpërdrejtë jep shumën prej 300 eurove, personit zyrtar H.A. instruktor dhe pronar i auto shkollës "...", me seli në ... me qëllim të dhënies të testit teorik në departamentin e patentë shoferëve.

Këso dore ka kryer veprën penale dhënia e ryshfetit nga neni 429 parag. 1 të KP-së

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10,21, 22, 41, 43, 45,46, 47, 49, 50, 52, 62, 69, 73, 74, 75, 76, 80, neni 428 parag.1, 429 parag, 1të KP-së dhe neni 365 të KPP-së, të akuzuarit i:

GJYKON

- Të akuzuarin H.A. për veprën penale si nën I, të dispozitivit ia shqipton dënimin me burgim në kohë zgjatje prej 5 (pesë) muajve si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 500 (pesëqindë) euro.
- Duke aplikuar nenin 47 të KP, me pëlqimin e të akuzuarit, dënimi i shqiptuar me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 2.500 (dymijepesëqind) euro.
- **Duke aplikuar nenin 80 parag. 1 nën parag. 2.4 të KP-së, të akuzuarit H.A., i shqiptohet dënimi unik me gjobë në shumë prej 3.000 (tremijë) euro, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 29.09.2017 deri me datën 26.10.2017, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në 5 (pesë) këste, 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguajë dënimin me gjobë, i njëjti zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet një ditë burg.**
- **Të akuzuarit B.S. për veprën penale si nën II të dispozitivit i shqiptohet dënimin me kusht, duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen veprë të tjetër penale.**

Të akuzuarve iu shqiptohet edhe:

DËNIMI PLOTËSUES

Ashtu që nga ta konfiskohen: një maic ngjyrë e zezë me firmë "...", një mbajtëse prej brezi për mbajtjen e pajisjeve ngjyrë e bardhë, një kamerë vëzhguese, një kabëll lidhëse e pajisjeve për përgjim, një antenë transmetues me mbishkrimin "...", modulation transimiter model, një bateri ku mundësohet kyçja e pajisjeve e mbështjellur me ngjyrë të zezë, një portofol ngjyrë e zezë brenda se cilës është aktivizuesi i pajisjeve për përgjimin si dhe 5 bateri të formatit LR03.

Obligohen të akuzuarit që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç të paguajnë shumën me nga 100 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – departamenti i krimeve të rënda, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/I.nr.158/2017 të datës 23.10.2017 kundër të akuzuarve H.A nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 parag. 1 të KP-së dhe B.S. nga ... për shkak të veprës penale dhënia e ryshfetit nga neni 429 parag. 1 të KP-së.

Prokurori i shtetit Mehdi Sefa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë aktakuzës ndaj këtu të akuzuarve H.A. dhe B.S., për veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 parag. 1 të KP-së dhe dhënia e ryshfetit nga neni 429 prag. 1 të KP-së, me që nga provat të cilat është mbështetur aktakuza dhe në veçanti nga vetë pranimi i fajësisë nga të akuzuarit në shqyrtimin e dytë, pa mëdyshje është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar në dispozitivat e akuzës dhe se në veprimet e të akuzuarve formohen elementet e veprave penale për të cilët janë akuzuar dhe se pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve kërkojmë nga gjykata që këta të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit. Me rastin e marrjes së shqiptimit të dënimit gjykata t'i ketë parasysh te gjitha rrethanat të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, për veç rrethanave renduese të ketë parasysh edhe rrethanën lehtësuese se këtu të akuzuarit kanë pranuar fajësinë, është hera e parë e tyre që ballafaqohen me vepra penale, janë penduar për veprat e kryer, andaj me rastin e marrjes së shqiptimit të dënimit ti ketë parasysh edhe këto rrethana lehtësuese.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.A. av. A.K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i akuzuari H.A. vullnetarisht ka pranuar fajësinë dhe e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese që shkojnë në favor të akuzuarit, faktin se ai është penduar për veprën e kryer, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, ushtron veprimtarinë e tij të auto shkollës me shumë se tri vite, është i licencuar nga ministria e infrastrukturës dhe se është i licencuar për dhënien e aftësimit të të gjitha kategorive sa i përket dhënies së patentë shoferit. I propozoj gjykatës të merr parasysh rrethanat familjare, është i gjendjes jo të mirë ekonomike, ka obligime familjare, dy fëmijë i ka student, njeri ne Kosovë, e tjetri në Turqi për këtë arsye ka qenë i obliguar që të merr kredi për shkollimin e tyre, arresti shtëpiak të njëjtin e ka vetëdisuar, andaj premtom që në të ardhmen nuk do të përsërite vepra të tilla, i propozoj gjykatës që ti merr te gjitha rrethanat parasysh dhe t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë, me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

I akuzuari H.A. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalën e mbrojtësit të tij dhe ka shtuar se ka probleme shëndetësore, ka pas edhe tragjedi ku ka qenë i obliguar të hynë në kredi, gjendjen ekonomike nuk e ka aq të mirë, pendohet për veprimet e tija premtom se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.S. av. H.K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i akuzuari B.S. pas konsultimit paraprakë ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza e prokurorit të shtetit për veprën penale nga neni 429 parag. 1 të KP-së, e ka pranuar fajësinë dhe për kryerjen e kësaj vepre penale është penduar thellë, andaj duke i patur parasysh rrethanat lehtësuese të cilat shkojnë në favor të të akuzuarit e posaçërisht duke patur parasysh se është hera e parë që i akuzuari ndeshët me ligjin, për veç saj kur dihet se i akuzuari ka kushte të vështira ekonomike, ka dy muaj që është punësuar si punëtor, kërkon nga gjykata që duke i patur parasysh të gjitha këto rrethana të akuzuarit i shqiptoj një dënim sa më të butë se edhe me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit.

I akuzuari B.S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, ka shtuar se është i gjendjes së dobët ekonomike, jeton me një pension të babës, premton se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm, është hera e parë që ballafaqohet me drejtësinë, kërkon nga gjykata që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se i akuzuari H.A., me datën 29.09.2017, rreth orës 08:25 minuta, në ... në cilësinë e personit zyrtar instruktor dhe pronarë i auto shkollës "...", me seli në ... në mënyrë të drejtë për drejtë pranon përfitim për vete që të mos veprojnë në pajtim me detyrën e tij zyrtare ashtu që nga kandidati B.S. pranon 300 (treqind) euro, për të mundësuar dhënien e testit teorik për patentë shofer, ashtu që vendos në trupin e B... pajisje elektronike për të komunikuar dhe ndihmuar në plotësimin e testit, me ç'rast gjatë testit teorik për patentë shofer në trupin e B.S. zbulohen pajisje dhe përcues elektronike nga ekzaminieri J.M. dhe koordinatori i departamentit të patentë shoferëve.

Se i akuzuari B.S. gjatë gushtit të vitit 2017 në kohë të pacaktuar në fshatin ... në mënyrë të drejtpërdrejtë jep shumën prej 300 eurove, personit zyrtar H.A. instruktor dhe pronar i auto shkollës "...", me seli në ... me qëllim të dhënies të testit teorik në departamentin e patentë shoferëve.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarve të cilët në shqyrtimin e dytë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësit e tij vullnetarisht kanë pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila iu vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 parag. 1 të KP-së dhe dhënia e ryshfetit nga neni 429 parag. 1 të KP-së, dhe për këtë gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor dhe iu shqiptoj dënimin

me gjobë dhe me kusht për të akuzuarit, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana renduese, e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarve, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, gjer më tani të pa gjykuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, janë njerëz familjar, janë mbajtës të familjeve, arsimimin e tyre, andaj gjykata të akuzuarit H.A. i shqiptoi dënimin unik me gjobë në shumë prej 3.000 (tremijë) euro, të akuzuarit B.S. dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale, duke menduar se dënimet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi shpenzimet dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.103/17 të datës 30.11.2017.

Procesmbajtësja
Florije Kolukaj

Kryetari i trupit gjykues,
Artan Sejrani

UDHËZIM JURIDIKË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.